



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 15/09/2017

**Proces-verbal nr. 2**

Bazuar në LIGJIN Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 38 “Programi buxhetor afatmesëm i rishikuar” pika 2, në datat 14-15 shtator 2017 u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me banorët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Ermal Saraçi Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Thanas Tona Drejtori I Ndërmarjes së Shërbimeve Publike.

Fjalën e mori i pari z. Kletjon Kita, I cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në process në qytetin e Korçës dhe Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet : Rikonstruksioni i Voskopojës, rikonstruksioni I rrugës Korçë- Lekas Loti I, Ndërtimi I Shkollës në fshatin Kamenicë, Rikonstruksioni I Shkollave në Lumalas e Vinçan, rikonstruksioni i Blv “Fan Noli”, “Rikonstruksioni i Pazarit të Vjetër të Korçës, Ndërtimi I “Kompleksit Multifunksional Sportiv dhe Kulturor”, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të banorëve për investimet në 3 vitet në vazhdim për në mënyrë që tu jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata I shohin më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Programin buxhetor afatmesëm”, dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që Bashkia e Korçës duhet ti shohë me përparësi banorët patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për periudhën 2018-2020.

Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara.

Bazuar në kërkesat e ngritura nga banorët dhe kryetarët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

- Ndërtim dhe menaxhim ujësjellësi si dhe rrjetit të kanalizimeve në fshatrat: Bulgarec, Belorta, Malavec, Shamoll, Biranj, Lumalas, Barç, Porodinë, Kuç, Ujëbardhë, Floq, Dvoran, Pulahë.
- Asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatrave : Ujëbardhë, Bulgarec, Neviçisht, Biranj, Lumalas, Barç, Porodinë.
- Ndërtim dhe rikonstruksion shkollash në fshatrat: Belorta, Malavec, Biranj, Çiflig, Barç, Kuç.
- Largimi i bagëtime nga fshati: Dvoran, Bulgarec, Neveçisht.

- Nga banorët e të gjithë fshatrave u kërkua vendosja e ndriçimit publik në rastet kur ende nuk ka përfunduar.

Të gjitha kërkesat e banorëve janë pasqyruar në informacionin e sipërcituar në zbatim të ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 38 “Programi buxhetor afatmesëm i rishikuar” pika 2.



























